

RAPORT TEKNIK DHE VNM

Studim Projektim Riveshje Sistemim Asfaltim rruga Elbasan – Banjë



Kontraktor AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Konsulent: BASHKIMI I OPERATORËVE
Studio PNI-2001 dhe Studio G&K

TIRANË NËNTOR 2014

Të dhëna të përgjithshme

Hartimi i këtij projekti u hartua në mbështetjes së kontratës Nr. 4329/6 datë 14/10/2014, lidhur ndërmjet Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) në cilësinë e **kontraktorit** dhe Bashkimit të operatorëve Studio PNI-2001 dhe Studio G&K në cilësinë e **konsulentit**, përfaqësuar nga Inxh. Arian Lako.

Grupi i Projektimit

DREJTUES I PROJEKTIT

Inxh. Arian Lako

Inxh. Dilaver Oshafi

HARTIMI I PROJEKTIT

Inxh. Arian Lako

Inxh. Dilaver Oshafi

Inxh. Spartak Tumani

Inxh. Josif Miti

Inxh. Mediana Beci

Inxh. Paolo Kraja

Inxh. Besjan Mulkurti

STUDIMI DHE RILEVIMI TOPOGRAFIK

Inxh. Jak Suli

Inxh. Sokol Allaraj

STUDIMI GJEOLLOJIK

ALTEA Studio dhe Gjeosat

Përfaqësuar nga Inxh. Skënder Allkja.

STUDIMI HIDROTEKNIK

Inxh. Bardhyl Shehu

Studim Projektim Sistemim Asfaltim Rruga Elbasan – Banjë

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT MJEDISOR

Inxh. Alfred Lako Inxhinier Mjedisi

AUTORITETI KONTRAKTOR Autoriteti Rrugor Shqiptar

Përmbajtja

1	Të përgjithëshme	1
2	Objektivat dhe hapat e ndjekura	2
3	Përshkrimi i gjurmës ekzistuese	3
3.1	Rruga	3
3.1.1	Segmenti I Elbasan – Cërrik – Banjë	3
3.1.2	Segmenti II Papër – Cërrik	9
3.1.3	Segmenti III Gostimë Mollas	13
3.2	Veprat e artit	20
3.2.1	Segmenti I Elbasan – Cërrik – Banjë	20
3.2.2	Segmenti II Papër – Cërrik	31
3.2.3	Segmenti III Gostimë Mollas	32
4	Hartimi Projekt-Idesë	34
4.1	Të përgjithëshme	34
4.1.1	Segmenti I Elbasan – Cërrik – Banjë	34
4.1.2	Segmenti II Papër – Cërrik	39
4.1.3	Segmenti III Gostimë - Mollas	43
4.2	Krahasimi ekonomik i varianteve	46
4.3	Mendimi i Grupit të projektimit	50
5	Metodologjia e përgjithëshme e ndërtimit	51
6	Konsultimin me publikun.	54
7	Ndikimet ndaj mjedisit	55
7.1	Konsiderata te përgjithëshme	55
7.2	Fushat e ndikimeve	55
7.3	Përshkrimi i projektit	55
7.4	Ndikimet nga projekti i rrugës	56
7.4.1	Ndikime që shoqërojnë transportimin e materialeve të ndërtimit	56
7.4.2	Ndikimet që shoqërojnë gërmimet e dheut	56

7.4.3	Humbja e drurëve në anë të rrugës	56
7.4.4	Ndikime përfituese	57
7.4.5	Ndikime mjedisore, humane dhe shoqërore.....	57
7.4.6	Ndikime përfituese	58
7.4.7	Ndikimet që shoqërojnë zbatimin e projektit	58
7.5	Vlerësimi i përgjithshëm i performancës mjedisore	60
7.6	Masat zbutëse dhe masat për rritjen e përfitimeve mjedisore.....	61
7.6.1	Masat zbutëse	61
7.6.2	Stadi ndërtimor zbatues. Masa zbutëse të detyrueshme.....	61
7.6.3	Stadi ndërtimor zbatues. Masa zbutëse të rekomanduara shtesë.....	62
7.6.4	Stadi i shfrytëzimit. Masa zbutëse të detyrueshme	62
7.7	Rekomandime për statet e ndërtimit dhe përdorimit	62
7.8	Rekomandime që lidhen me mungesën e informacionit dhe aktivitetet e mëtejshme.....	63
7.9	Dispozitat për përmirësimin e kushteve mjedisore.....	63
7.9.1	Kushtet kontraktore	64
7.10	Plani i monitorimit mjedisor	65
7.10.1	Monitorimi Mjedisor	65
7.10.2	Faza e projektimit	66
7.10.3	Faza e ndërtimit.....	66
7.10.4	Faza e zbatimit dhe mirëmbajtjes	67
8	Studimi Topografik.....	68
8.1	Segmenti Elbasan – Cërrik dhe Papër Cërrik	68
8.1.1	Procesi i matjes.....	71
8.2	Segmenti Cërrik Banjë dhe Gostimë Mollas.....	75
9	Studimi gjeologjik.....	78
10	Studimi Hidrologjik	79
10.1	Të përgjithshme.....	79
10.1.1	Qëllimi:.....	79
10.1.2	Pozicioni gjeografik:.....	79

10.1.3	Te dhenat baze:.....	79
10.2	Kushtet klimatike.....	80
10.2.1	Zonat klimatike te territorit, ku shtrihet gjurmetimi i rrugës:.....	80
10.2.2	Temperatura e ajrit:.....	80
10.2.3	Lageshtia e ajrit:	81
10.2.4	Reshjet atmosferike.....	82
10.3	Kushtet hidrologjike.....	85
10.3.1	Relievi i zones, ku kalon gjurmetimi i rrugës.....	85
10.3.2	Analiza e reshjeve maksimale ditore.....	85
10.3.3	Analiza e lakoreve lartesi-kohezgjatje-probabilitet (LKP)	86
10.4	Llogaritjet hidrologjike:.....	87
10.4.1	Ndarja dhe pershkrimi i pellgjeve ujëmbledhës te shqyrtuar	87
10.4.2	Percaktimi i shtreses llogaritese te shiut.....	91
10.4.3	Metoda e llogarijes se prurjeve maksimale:	92
11	Harta e zonave ujëmbledhëse	93
12	Studimi i projektimit të Shtresave Rrugore	94
12.1	Burimet e informacionit dhe matjet e trafikut.....	94
12.2	Trafiku Ditor i Adoptuar në objektin: ” Studim Projektim Sistemim-Asfaltim Rruga Elbasan-Banjë”, Dt 20.10.2014.....	94
12.3	Të dhëna të tjera:	95
12.4	Të dhënat llogaritëse të trafikut për metodën AASHTO.....	95
12.5	Përpunimi i të dhënave dhe derivimi i vlerave llogaritese te trafikut.....	96
13	Raporti i Shpronësimeve.	98
14	Kërkesat për leje apo liçenca	99
15	Vizatimet.....	100
16	Preventivi	102
16.1	Segmenti i Parë Elbasan - Cërrik – Banjë Vatiantin e I.....	102
16.3	Segmenti i Parë Elbasan - Cërrik – Banjë Vatianti II.....	106
16.4	Segmenti i Parë Elbasan - Cërrik – Banjë Vatianti III	109
16.6	Segmenti i Dytë Papër – Cërrik Variantin e I.....	110

16.8	Segmenti i Dytë Papër – Cërrik Variantin e II.....	114
16.10	Segmenti i Tretë Gostimë–Mollas Varianti I.....	118
16.12	Segmenti i Tretë Gostimë–Mollas Varianti II.....	122
17	Standardet dhe normativat	126

1 Të përgjithëshme

Rruga Elbasan-Cërrik-Banjë, Papër Cërrik dhe Gostimë - Mollas edhe më tej, ndodhen në gjendje tejet të amortizuar, prej vitesh në to nuk janë kryer investime me gjithë shqetësimin e vazhdueshëm të banorëve si dhe trajtimin e këtij problemi në media. Në këto rrugë vlen të theksohet mungesa e sinjalistikës. Si pasojë e zhvillimeve demografike të ndodhura në këto 20 vitet e fundit, kjo rrugë në pjesën më të madhe të saj kalon në qendrat e banuara rritja e të cilave në numër popullsie dhe mungesa e investimeve, në rrugë, kaçuar njëkohësisht edhe në rritjen e numrit të aksidenteve rrugore, ku veçanërisht në zonën e fshatit Kuqan, ku dhe prezenca e kalimtarëve, kryesisht nxënës shkollash, është më e madhe. Objekti “Studim Projektim Sistemim Asfaltim Rruga Elbasan – Banjë” planifikuar të realizohet me fonde të buxhetit të shtetit për këtë vit, është marrë për tu realizuar nga ky bashkim operatorësh me Prokurim publik me procedurë të hapur, “Shërbime Konsulence”

Objekti i këtij studimi është rikonstruksioni i rrugëve ekzistuese:

- Elbasan– Banjë (Fillon nga ura e Shkumbinit deri para digës së HEC të Banjës, aty ku fillon rruga e rindërtuar në drejtim të qytetit të Gramshit, me një gjatësi prej 23.184 km, mëposhtë do ta quajmë Segmenti I
- Papër – Cërrik me gjatësi 5.674 km, që po e quajmë Segmenti II
- Gostimë– Mollas me gjatësi 7.803 km, Segmenti III

2 Objektivat dhe hapat e ndjekura

Objektivi kryesor i këtij projekti është:

Rritja e nivelit të shërbimit dhe e sigurisë në të tre këto segmente rrugore dhe sjellja e tyre në parametrat e standardeve shqiptare si edhe kërkesave të kohës.

Përveç këtij objekti, realizimi i projektit do të bëjë të mundur njëkohësisht dhe arritjen e objektivave të tjera si:

- Rritjen e nivelit të jetës në zonat e banuara që përshkohen nga këto segmente
- Krijimin e kushteve më të mira për fermerët që lëvizin në këto rrugë
- Rritjen e pastërtisë së ajrit
- Lëvizja e njerëzve në zonat urbane do të jetë më e sigurt dhe komode nga vendosja e trotuare.

Për arritjen e këtij qëllimi ky bashkim operatorësh ka realizuar detyrat e mëposhtme në përputhje me termat e referencës (TeR):

1. Lidhur me këtë projekt kemi marrë në konsideratë projekte dhe studime të mëparshëm që kanë të bëjnë këtu me objekt. Projektet e dy urave ura e Shkumbinit dhe Ura e Sulovës, shiko paragrafin 3.2
2. Hartimin e projektit në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe veçanërisht duke u mbështetur mbi standardin shqiptar të projektimit të rrugëve (KTP 2001) dhe të standardeve tjera të miratuara nga institucione shqiptare.
3. Hartimin e studimit topografik të detajuar sipas kërkesave të TeR
4. Për hartimin e këtij projekti kemi realizuar Studimin gjeologjik dhe atë hidrologjik dhe në mbështetje të tyre kemi marrë masat e nevojshme inxhinerike për çdo rast.
5. Paraqitjen e të dhënave të hollësishme mbi shpronësimet, e tokës apo Objekteve, duke dhënë qartë kufijtë e shpronësimeve, sipërfaqet që kërkohet të shpronësohen dhe pronarët përkatës, mbështetur në bashkëpunimin me ZRRPP dhe Pushtetin Lokal
6. Realizimin e analizës ekonomike të fazave të projektit duke u mbështetur në llogaritjet e bazuara në vizatime dhe terrenit ku kalon rruga dhe duke përdorur çmimet e miratuara me V.K.M. NR 568 datë 25-Korrik-2013

3 Përshkrimi i gjurmës ekzistuese

3.1 Rruga

Rruga objekt i këtij studimi shtrihet e gjitha në teren fushor me përjashtim pjesës në afërsi të hidrocentralit të Banjës, ku ajo fillon e ngjitet ndjeshëm në terren kodrinor.

Nisur nga shtrirja e akseve rrugore të përfshira në këtëprojekt për lehtësi dhe qartësi studimi po i ndajmë sipas segmenteve të mëposhtme:

- ❖ Segmenti I Elbasan – Cërrik – Banjë
- ❖ Segmenti II Papër – Cërrik
- ❖ Segmenti III Gostimë Mollas

Në paragrafët e mëposhtëm po paraqesim gjendjen ekzistuese të secilit prej këtyre segmenteve:

Objekti shtrihet në bashkitë e komunat e mëposhtme:

Bashkia Elbasan, Komuna Shirgjan me 9,232 banorë, Komuna Gjergjan me 7,524 banorë, Komuna Papër me 8,913 banorë, Bashkia Cërrik me 14,739 banorë, Komuna Gostimë me 12,136, Komuna Klos me 9,232 banorë dhe Komuna Mollas me 7,427 banorë¹

3.1.1 Segmenti I Elbasan – Cërrik – Banjë

Segmenti Elbasan - Cërrik – Banjë me një gjatësi tëpërgjithshme prej 23.2 km, kalon përgjatë 3 Komunave Shirgjan, Gjergjan, Gostimë dhe bashkisë Bashkia Cërrik, të gjitha pjesë e qarkut të Elbasanit. Ajo që vihet re dhe që përbën problemin kryesor të kësaj rrugë është prezenca e zonave të reja të banimit përgjatë saj, gjë që ka çuar në rritjen e numrit të aksidenteve.

3.1.1.1 Elementët e inspektimit

Problematikat e hasura në të gjithë pjesën në vazhdim të rrugës është si më poshtë:

1. Nga pikëpamja planimetricke si dhe në përputhje me kategorinë e saj rruga paraqitet përgjithësisht e mirë me përjashtime të vogla, problem përbën kthesa në progresivin 2+500km ku kthesa ekzistuese është me reze më të vogël se 50m ndërsa kërkesa për komoditet lëvizjeje për të mos ecur me shpejtësi minimale rekomandohet 75-80m. Gjerësia e pjesës së asfaltit ndryshon 5.5 deri në 6m.
2. Në altimetri e gjithë rruga paraqitet me parametra shumë të mirë.
3. Nga pikëpamja e shtresave rrugore ato paraqiten të dënuara dhe me probleme si në nënshtres ashtu edhe në disa zona edhe në taban.

¹Të dhëna nga Wikipedia të vitit 2012

4. Vend qëndrimet e autobusëve ndonëse është një rrugë e populluar nga kalimtarët dhe mbrojtja e lëvizjes së tyre veçanërisht pranë shkollave tërësisht e pa trajtuar. Si segment problematik përmendim atë tëfshatit Mjeks (km 4), dhe Kuqan (km 6). Gjithsej në këtë segment janë 5 shkolla.
5. Përgjatë këtij segmenti nga km 2 deri km 7 shtrihet kanali vaditës Naum Panxhi, i cili në segmente të veçanta është pranë trupit të rrugë dhe rruga krejtësisht e pa mbrojtur, seksioni tërthor i tij në disa nga vendet e matura ishin gjerësia sipër $b=2.0\div 2.4\text{m}$ dhe me thellësia=1.5m. Po kështu nga fillimi deri në fund i këtij segmenti kemi shpesh edhe kanale të vegjël vaditës të rindërtuar vitet e fundit.
6. Degëzimet me rrugët ose rrugicat e fshatrave të pa trajtuara (gjithsej 40). Për sa i përket kryqëzimeve më të mëdha veçojmë ato të Llixhave, Mjeksit, Kryqëzimin e madh të Cërrikut, të Belshit dhe atë të Gostimës, të cilët gjithashtu janë të pa trajtuar nga pikëpamja e ndarjes së fluksit të lëvizjes dhe veçanërisht atë të këmbësorëve.
7. Mungesa e plotë elementeve të sigurisë në rrugë veçanërisht pranë zonave të banuara.
8. Sinjalistika e pa mjaftueshme vertikale dhe mungesa e plotë e sinjalistikës horizontale.

3.1.1.2 Disa nga pikat më problematike

Ura ekzistuese që kalon mbi lumin Shkumbin dhe është në dalje të qytetit të Elbasanit km 0.00 deri 0.240. Këtë segment në planimetri e kemi emërtuar Aksi Kryesor Elbasan Cërrik Banjë

Ura ekzistuese është me 11 Hapësira drite, ku 10 H.D=10 x22.2m=220m dhe një hapësirë drite është me gjatësi, L=11.48m, hapësirë e cila ishte në mbushje. Gjatësia totale e urës ishte, L=233.44 m




Figura 3-1 Pamje e përgjithshme nga projekti ekzistues²

Ura ekzistuese ka gjerësi, $B=7.0\text{m}$, ku përfshihen dhe trotuare në të dy anët e saj me $B=2\times 1.0\text{m}$, ura në të dy anët e saj kishte parapete b/a po kështu kishte dhe guard rail metalik ekzistuese.

² Arkivi Qendror i ndërtimit




Figura 3-2 Prerje tërthore e Urës



Figura 3-3 Parapetet dhe guard rail-et e dëmtuara

Disa prej pilotave të urës ekzistuese ishin të dëmtuara dhe të deformuara, për të cilat mendojmë se duhet të merren masa inxhinerike për përforcimin e tyre deri në kuotën e rrjedhjes së ujit. Po kështu pjesa dërmuese e parapeteve ekzistues b/a, ishin të dëmtuara ose mungonin fare. Trarët e parapërgatitur të urës ekzistuese dukeshin të dëmtuar, për këtë arsye kërkohet që të merren masa për riparimin e tyre. Kemi dëmtime të fugave etj. Për të gjitha këto janë bërë foto përkatëse.



Figura 3-4 Çeliku i korrodur i trarëve



Figura 3-5 Pilot e dëmtuara

Rruga nga ky segment deri në fund paraqitet me probleme të shumta kryesisht dëmtime të shtresave rrugore, jo vetëm ato asfaltike por edhe të nënshtresave. Nga KM +0.240 e në vazhdim rruga ekzistuese kishte gjerësi, e cila përmbush parametrat sipas termave të referencës për të realizuar rrugë urbane me trotuare në dy anët e saj.

Progresivi +0.325-+0.700 kanal i veshur betoni, djathtas,

Nga 0.700 deri në 1.775 do të ruhet drejtimi i bordurave ekzistuese dhe trotuari në krahun e majtë. Në këtë segment është bërë një investim në 2011 për ndërtimin e kolektorit 1500mm, aktualisht në këtë kolektor shkarkohen vetëm ujërat e zeza. Në këtë pjesë shtresat e rrugës janë tërësisht të dëmtuara



Figura 3-6 Pjesa e rrugës mbas urës së Shkumbinit

Në kilometrin 3+140 Urë me 3 hapësira, me ballna dhe pila prej muraturë guri, mbistruktura me trarë dhe soletë të hedhur në vend, në krahun e djathtë të urës ishte akuadukti i kanalit Naum Panxhi.

Nga piketa 12+700 fillon rruga urbane e qytetit të Cërrikut e cila ishte e trajtuar si rrugë urbane me kunete në njërin anë të rrugës, me trotuar në krahun e djathtë dhe me bankinë në krahun e majtë. Trotuari ekzistues i krahut të djathtë ishte me pllaka po kështu në këtë segment rrugë ishte zgjidhur me ndriçim në krahun e djathtë.

Rruga ekzistuese që përshkonte qytetin e Cërrikut kishte filluar të dëmtohej, u vunë re deformacione të trupit të rrugës kjo për shkak se ujërat në krahun e majtë nuk kishin mundësi shkarkimi. Gjate hulumtimit të gjendjes së rrugës ekzistuese, u vë re që dhe kuneta ekzistuese e këtij segmenti rrugor që kalonte në qytet ishte me dëmtime të mëdha.



Figura 3-7 Rruga urbane në Cërrik

Tek piketa 13+800 është kryqëzimi në dalje të qytetit të Cërrikut dhe që lidhet me vazhdimin e rrugës që të çon për Banjë- Gramsh dhe në krahun tjetër të çon për te segmenti dytë Papër - Cërrik.



Figura 3-8 Kryqëzimi në dalje të Cërrikut

Në kilometrin 17+850 Urë me 4 hapësira dritë me nga 12 m secila, me ballna dhe pila prej betoni masiv, me qemer në formë harku me trashësi 85cm. Gjatësia totale e urës ekzistuese ishte $B=58.0m$, ndërsagjerësia ishte $B=6.5m$. Ura ekzistuese është në gjendje të mirë, kishte trotuare ekzistuese me $B=1.0m$ në të dy anët e saj. Ura ekzistuese nuk kishte parapet mbrojtëspërkëtë duhet me pa tjetër të kompletohet me parapet mbrojtëse dhe guardrail për të mbrojtur kalimtarët kur kalojnë mbi urë ekzistuese.



Figura 3-9 Urë ekzistuese qemeri

Në kilometrin 18+400 kemi degëzimrrugëdjathtas, nëkëtëdegëzimështë dhe qendra e fshatit Gostitmë.

Nëkilometrin 18+700 është shkolla e Gostimës “Miranda Baku”

Nga km 18+00 e ne vazhdim rruga është e ngushte me gjerësi asfaltike, $B=5.5\text{m}$, por sqarojmë se ne këtë segment rrugë e ne vazhdim rruga ekzistuese nuk kishte bankina. Po kështu rruga ekzistuese ne segmente te veçanta ishte me poshtë se kanali ekzistues kullues gjë që sillte ne raste reshjeshpërmbytjen e rrugës ekzistuese dhe dëmtimin e saj për shkak tëqëndrimit të ujit përnjë kohë të gjatë në trupin e rrugës.

Ky segment përfundon nëkilometrin23.184 dhe do të lidhet me vazhdimin e rrugësekzistuese së asfaltuar ne vitin 2013 nga ARrSh



Figura 3-10 Kryqëzimi për në Mollas

3.1.2 Segmenti II Papër – Cërrik

Ky segment rrugë fillon me piketën 651 tek ura ekzistuese, e cila ka tre hapësira drite në forme qemeri H.D=3x10m dhe dy hapësira drite H.D=1x24m dhe H.D=1x20m, këto dy hapësira kishin pese trarë te parapërgatitur ne gjendje te mire. Gjerësia e urës ekzistuese është, B=6.0m pa përfshirë dy trotuaret anësorë me gjerësi, b=2x1.0m. Ura ka parapete ekzistuese metalike me lartësi, H=90cm. Ura ne përgjithësi ishte ne gjendje te mire, përjashtuar gjendjes se trotuareve dhe parapetit metalik, te cilët ishin te dëmtuara . Po kështu ne segmente te veçanta te urës ekzistuese mbishtresa e betonit te urës kishte dëmtime.

Për të gjitha këto janë bërë foto përkatëse.



Figura 3-11Ura ekzistuese, 3x10m dhe dy hapësira drite 1x24m dhe 1x20m



Figura 3-12 Fugat në urën ekzistuese



Figura 3-13 Pilat dhe trarët e urës

Në kilometrin 0+.140, djathtas kemi një rrugë sekondare që lidhet me rrugën kryesore.

Në kilometrin 1+130 kemi urë skema statike me qemer HD=5m. Në kilometrin 1+300 deri 1+375, majtas kemi varrezat ekzistuese.

Në kilometrin 1+410 kemi Urë të vogël me qemer DH=5m. Në kilometrin 1+925 kemi ndërprerje të shinave të trenit me këtë rrugë, shinat ekzistuese janë ato të ish Tecit Cërrik, dhe rafinerisë së naftës. Në këtë rast me patjetër duhet të ruhet kuota e shinave ekzistuese. Pas shinave ekzistuese kemi një segment rrugëtepër të dëmtuar ku duhet të ndërhyhet me të gjitha nënshtresat dhe shtresat e rrugës.



Figura 3-14 Shtresa të dëmtuara

Ne vazhdim kemi kanale kullues në dy anët e rrugës ekzistuese dhe përshkak të këtyre kanaleve në të dy anët e rrugës kemi dhe dëmtime të mëdha të shtresave rrugore, kjo për shkak se kanalet anësore që shërbejnë për largimin e ujërave ishin me lartësi se kuota e

rrugës. Pra ky segment fillon nga km.2+300m deri ne km.2+800m. Po kështu ne këtë segment rrugë kemi dhe ndërtime ekzistuese në të dy anët e rrugës, përkëtë arsye mendojmë se duhet që ky segment rrugë të trajtohet si rrugë urbane.



Figura 3-15 Kanalet kullues anës rrugës

Në kilometrin 3+350 deri në km 3+675, djathtas rrugës nacionale Papër-Cërrik kemi ish Tecin e rafinerisë së naftës Cërrikut. Pas kësaj pikë të në krahun e djathtë të rrugës ekzistuese kemi një kanal te veshur me beton.



Figura 3-16 Kanalet e veshur anës rrugës

Në kilometrin 2+900 kemi tombino ekzistuese. Në kilometrin 3+075 djathtas e majtas kemi rrugë sekondare që lidhet me rrugën nacionale Papër-Cërrik.

Nga km.2+800 deri te km.3+400 rruga ekzistuese është ne gjendje te mire. Pas këtij segmenti rruga ekzistuese është tepër e dëmtuar kjo për shkak se ka kanalet anësore të cilat

janë ne dy anët e rrugës janë më larte se kuota ekzistuese e rrugës, gjë që sjell qëujërat pas rënies së shirave rrinëpërnjë kohë të gjatë në rrugë, gjë që ka sjell dhe dëmtimin e rrugës ekzistuese.

Nga kilometri 3+925 deri 4+375 kemi ndërtime në dy anët e rrugës, përkëtë arsye mendojmë që ky segment rrugë të trajtohet si rrugë urbane.

Në km 4+160 kemi kryqëzimin e rrugës për nëBelsh.



Figura 3-17Ndërtime afër rrugës kryqëzimi i Belshit

4+200m kemi përsërinjë segment rrugë ekzistuese te dëmtuar, ku duhet me patjetër që tëndërhyhetrishtazi duke filluar që nga nënshtresat baze.



Figura 3-18Segment i dëmtuar

Nga kilometri 5+300 deri ne 5+800 kemi rrugë urbane ekzistuese qëështë brenda qytetit te Cërrikut. Krahu i majtë ishte me trotuare ekzistuese në gjendje te keqe, ishte e kompletuar me pemë dhe ndriçim. Gjate hartimit te projektit te kihet parasysh qe krahu i majtë i këtij segmenti rrugor te ruhet sepse kemi në gjendje te mire pemët ekzistuese dekorative.

3.1.3 Segmenti III Gostimë Mollas

Ky segment rrugë fillon në qendër të komunës Gostimë kilometri 0+000 dhe vazhdon deri në kilometrin 7+803 pranë fshatit Mollas, shiko planimetrin e Orografinë

Vlen të theksojmë se edhe ky segment shtrihet në zonë fushore dhe të bie në sy zhvillimi bujqësor

Pjesa e parë nga km 0+000 deri 0+900 përfaqëson një rrugë e cila kalon në zonë urbane në të dy anët e saj ka ndërtime me banesa private, dhe si e tille duhet te trajtohet si rrugë urbane.



Figura 3-19 Pjesa hyrëse , fillimi i rrugës

Ky segment rrugështëtërishti dëmtuar. Rruga ekzistuese e këtij segmenti është e ngushte që nuk plotëson asnjëkushte teknik. Në të dy anët kishte kanale kullues ekzistues që shërbejnë për largimin e ujërave të shiut. Ky segment rrugëpër te cilën duhet të trajtohet si rrugë urbane shkon deri ne piketën0+800 para deri ne kryqëzimin ekzistuesku rruga kthen majtas për në fshatin Mollas.



Figura 3-20 Segment i dëmtuar

Në vazhdim rruga në tëdy anët e saj ka kanale kullues ekzistues.



Figura 3-21 Segment i dëmtuar kilometri 0+900 deri 1+200

Në kilometrin 1+350 fillon ura e Sulovës e cila kalon mbi lumin Devoll, kjo urë është me një kalim dhe ka H.D=11x22m. Është me parapet betoni në të dy anët, ku pjesërisht janë të dëmtuara. Ura është ndërtuar me pila tip kolon rrethore dhe mbistruktura me trarë të parapërgatitur tip. Rekomandojmë që paralel me urën ekzistuese të ndërtohet një urë e re me këtë gjatësi. Kjo për të krijuar komoditet në lëvizjen e automjeteve. Në dalje të urës në krahun e majtë kemi një tombino ekzistuese që shkarkon ujërat e kodrës dhe të rrugës sekondare (të fshatit Floq) që është në krahun e majtë. Këto ujërashkarkojnë në krahun e sipërm të urës ekzistuese. Po kështu në krahun e sipërm të urës ekzistuese kemi dhe mbrojtje me blloqe betoni.



Figura 3-22 Ura e Sulovës



Figura 3-23 Ura e Sulovës



Figura 3-24 Mbrojtjet lumore me blloqe betoni

Pas urës së Sulovës, rruga ekzistuese në vazhdim është e dëmtuar. Në piketën 2+025 majtas kemi degëzimrrugë, me rrugën ekzistuese kryesore të Gostimë - Mollas. Në vazhdim kemi në të dy anët e rrugës kanale, në krahun e majtë kemi kanal kullues ekzistues, i cili ishte i madh ku dhe kishte prurje të mëdha, ndërsa në krahun e djathtë kemi kanal vaditës ekzistues. Këto kanale e shoqërojnë rrugën deri në Mollas.



Figura 3-25 Segment i dëmtuar



Figura 3-26 Segment i dëmtuar

Në piketën 2+025 kemi tombino ekzistues, ku kjo kuotë duhet detyrimisht të ruhet. Pas këtij segmenti rruga ishte tepër e dëmtuar, kjo për shkak se kanali kullues ekzistues dhe ai vaditës ishin më lartë se kuota e rrugës kryesore. Gjatë vizitës sonë në objekt vumë re se dhe në këtë periudhë, kishte probleme me qarkullimin e automjeteve kjo për shkak se të gjitha ujërat e kanalit kullues kishin kaluar në rrugë dhe nuk kishin asnjëmundësi shkarkimi, sepse vetë rruga ishte në kuotë më poshtë se kanalet.



Figura 3-27 Segment i dëmtuar



Figura 3-28 Segment i dëmtuar

Në piketën 3+825 kemi tombino ekzistuese.

Pas kësaj piketë, kemi njësegment përsëri tepër të dëmtuar kjo nga prezencia e ujërave që rrinë për njëkohë të gjatë në rrugë, në pamundësi për të shkarkuar. Kjo për shkak se kanali kullues dhe ai vaditës janë më lartë se rruga. Në piketën 3+675 kemi kalim me tub çeliku. Në piketën 4+900 kemi njëurë të vogël ku kalon një përrua ekzistues. Po pas kësaj piketë kemi përsëri njësegment rrugë tepër të dëmtuar kjo për shkak se ujërat rrinë për njëkohë të gjatë në rrugë në pamundësi për të shkarkuar. Kjo vjen si rezultat se kanali kullues dhe ai vaditës janë më lartë se kuota e rrugës.

Në piketën 5+175 majtas kemi lapidar ekzistues. Në piketën 5+425 përfundon dhe ky segment i dëmtuar.



Figura 3-29 Urë kilometri 4+900



Figura 3-30 Segment i dëmtuar

Në piketën 5+510, 5+770 kemi tombino ekzistuese. Në piketën 5+775 është një urë te vogël ku kalojnë ujërat e një përroi ekzistues, duhet te kihet kujdes që detyrimisht të ruhet kuota në këtë pikët pasi edhe shtrati i përroit është i veshur dhe pjesërisht i pastruar.

Në piketën 5+925, 6+150, kemi tombino ekzistuese. Po kështu dhe në piketën 6+775 duhet të ruhet detyrimisht kuota e tombinos ekzistuese, në këtë pikët kalon njëpërroi ekzistues edhe ky me shtratin e veshur me beton dhe pjesërisht i pastruar. Në piketën 7+000 kemi dhe tabelën që tregon fillimin e fshatit Mollas ku dhe përfundon ky segment rrugor sipas Ter. Më pas rruga është në gjendje të mirë dhe është rindërtuar me një financim të viteve të fundit nga FSHZH.



Figura 3-31 Urë te vogël kilometri 5+775



Figura 3-32 Urë te vogël kilometri 6+775 Fshati Selvias



Figura 3-33 Segment i financuar nga F.SH.ZH

3.2 Veprat e artit

Veprat e artit në këto segmente përgjithësisht kanë njëjetëgjatësi mbi 50 vjeçare, shumica e tyre përbëhet nga tombino e ura të vogla, me HD=5-6m. Në veprat më të mëdha përmendim 6 ura dy ura që i përkasin atyre të ndërtuara në vitet 70-80, Ura e Shkumbinit dhe Ajo e Sulovës, pjesërisht rindërtimi i urës së Papërit mbi lumin Shkumbin, Ura ka skemë, 3x10m (qemer) dhe dy hapësira drite 1x24m dhe 1x22m. Një urëtjetër në aksin Elbasan Cërrik në kilometrin 3+140 me 3 hapësira, me ballna dhe pila prej muraturë guri, mbistruktura me trarë dhe soletë të hedhur në vend, në krahun e djathtë të urës ishte akuadukti i kanalit Naum Panxhi (Figura 3-34)



Figura 3-34 Kanali N. Panxhi në urën km 3+140

Në vazhdim kemi urën në km 17+825 – 17+875 me katër hapësira drite me qemer betoni me 4 HD 12m, sipas banorëve të zonës ndërtuar në para viteve 1940, dhe ndodhej në gjendje të mirë

3.2.1 Segmenti I Elbasan – Cërrik – Banjë

Përshkrim i detajuar i veprave të artit që ndodhen në këtë segment jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 3-1 Lista e veprave të artit në Segmentin e parë Elbasan – Cërrik – Banjë

Nr Progresivi		Vepra e artit	Përshkrimi i veprës
1	0,1	Urë	Urë me 11 hapësira, me ballna dhe pila prej betoni të armuar. Mbistruktura përbehet me trarë prej betoni të armuar në formë T-je dhe soletë. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 250m ndërsa gjerësia e saj prej 10,50 m. Gjatësia aksiale e 10 kamatave tëpara të urës është prej 22,20m ndërsa gjatësia e kempatës së 11 nga ana e Cërrikut është prej 11,45 m. Ura është me 2 vija kalimi me gjerësi prej 3,50m ndërsa gjerësia e trotuareve është prej 1,75m. Njëkëtë rast mungojnë bankinat. Si elementë kufizues anësore shërbejnë guard- rail dhe parmakë prej betoni që kufizojnë trotuarin.
2	0,35	Tombino	Tub çeliku me diametër afërsisht 45 cm dhe me portale prej betoni. Gjatësia e mbistrukturës është prej afërsisht 1,25m, ndërsa gjerësia e saj prej afërsisht 14m. Gjerësia e kalimit është prej afërsisht 5,4m, ndërsa ajo e bankinave prej 1,2m. Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
3	0,375	Tombino	Tub çeliku me diametër afërsisht 45 cm dhe me portale prej betoni. Gjatësia e mbistrukturës është prej afërsisht 1,25m, ndërsa gjerësia e saj prej afërsisht 14m. Gjerësia e kalimit është prej afërsisht 5,4m, ndërsa ajo e bankinave prej 1,2m. Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
4	0,62	Tombino	Tombino rrethore me diametër afërsisht 80cm me portale prej betoni të armuar. Gjatësia totale e mbistrukturës është afërsisht 2,5m ndërsa gjerësia e saj 8,00m. Kemi dy vija kalimi dhe gjerësia e kalimit është 2,65m, ndërsa ajo e bankinave është 1,00m. Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore
5	1,775		Është kalimi rrugës ku shkarkon kolektroi ekzistuese
6	1,915	Tombino	Tombino rrethore prej betoni me diametër (1.00 – 1.20) metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej afërsisht 2,5m ndërsa gjerësia e saj prej 6,5 m. Kemi dz vija kalimi me gjerësi të vijës kalimit 2,9m. Mungojne trotuare, bankina dhe sistemet kufizuese anësore.
7	2	Tombino e re Ø1000mm	Ky segment ka probleme me largimin e ujërave te bardha
8	2,5	Urë	Urë me 3 hapësira dhe mbistrukturë të përbërë me elementë të parapërgatitur (soletone).Gjatësia totale e mbistrukturës është prej afërsisht 25,0m ndërsa gjerësia e saj prej 7,5 m. Ura është e përbërë me

			3 hapësira, me hapësire dritë të hapjes së një kampate prej 6,7 m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,5m. Kemi trotuarë vetëm në njërën anë me gjerësi afërsisht prej 1,00m. Bankinë vetëm në njërën anë me gjerësi prej 1,50m. Mungojnë sistemet kufizuese anësore.
9	2,66	Tombino Ø600mm	Tombino rrethore prej betoni me diametër 0.6 metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 9,50m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të vijës së kalimit prej 3,50m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m .Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
10	2,675	Tombino ekz. F1000mm	Kjo tombino nuk kryen funksion por duhet spostuar tek prog.2.625
11	2,715	Tombino	Hyrja me soleton H.D=1.0m dhe dalja me tuba betoni me diametër 0.6 metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 9,50m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të vijës së kalimit prej 3,50m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m .Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
12	2,76	Tombino	Hyrja me soleton H.D=1.0m dhe dalja me tuba betoni me diametër 0.6 metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 9,50m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të vijës së kalimit prej 3,50m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m .Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
13	2,875	Tombino	Hyrja me soleton H.D=1.0m dhe dalja me tuba betoni me diametër 0.6 metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 9,50m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të vijës së kalimit prej 3,50m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m .Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
14	3,1	Urë H.D=2.5m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 5,00 m ndërsa gjerësia e saj prej 6,35m. Gjatësia e hapësirës dritë të kampatës është prej 2,50m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,78m. Mungojn trotuaret, bankinat dhe sistemt kufizuese anësore.
15	3,14	Urë, H.D=3x10m, Perroi i Kryezjarthit	Urë me 3 hapësira, me ballna dhe pila prej muraturë guri, mbistruktura me trarë dhe soletë të hedhur në vend. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 45,0m ndërsa gjerësia e saj prej 6,0m. Gjatësia e hapësirës dritë të një kampate është prej 10,0m. Kemi dz vija kalimi me gjerësi prej 2,6m. Mungojnë trotuaret dhe bankinat. Si sisteme kufizuese anësore kemi parrmakë prej b/armeje.

16	3,735	Tombino Ø800mm	Tombino rrethore prej betoni me diametër 0.8 metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,00m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të vijës së kalimit prej 2,65m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m. Mungojnë trotuaret dhe sistemet e kufizuese anësore .
17	3,775	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 8,5m ndërsa gjerësia e saj prej 7,0m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 5,5m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të tyre prej 2,60m. Mungojnë trotuare, bankina dhe sisteme kufizuese anësore.
18	3,875	Tombino Ø800mm	Tombino rrethore prej betoni me diametër 0.8 metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 9,50m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të vijës së kalimit prej 3,50m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m .Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
19	3,925	Tombino Ø800mm	Tombino rrethore prej betoni me diametër 0.8 metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 9,50m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi të vijës së kalimit prej 3,50m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m .Nuk ka trotuare dhe sisteme kufizuese anësore.
20	4,1	Urë, H.D=1.5m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend. Gjatësia totale e mbistrukturës është 1.5m ndërsa gjerësia e saj prej 7,5m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,75m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
21	4,435	Urë, H.D=1.5m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend. Gjatësia totale e mbistrukturës është 1.5m ndërsa gjerësia e saj prej 7,5m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,75m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
22	4,51	Tombino e re Ø1000mm	Ka probleme ky segment, meqenese nuk ka ku shkakrkojne ujërat e rrugës
23	4,68	Urë, H.D=1.5m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend. Gjatësia totale e mbistrukturës është 3,0m ndërsa gjerësia e saj prej 8,2m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 1,3m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,85m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.

24	4,745	Tombino e re Ø1000mm	Ka probleme ky segment, meqenese nuk ka ku shkarkojne ujërat e rrugës
25	4,95	Urë, H.D=1.5m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 3,0m ndërsa gjerësia e saj prej 8,2m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 1,3m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,85m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
26	5,175	Urë, H.D=10m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 10m ndërsa gjerësia e saj prej 6,6m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 8,4m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m. Mungojnë totuaret, bankinat dhe sistemet kufizuese anësore.
27	5,53	Urë, H.D=1.5m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 5,2m ndërsa gjerësia e saj prej 7,5m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej (1,5-1,65)m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,75m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
28	6,315	Urë, H.D=1.0m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 2,5m ndërsa gjerësia e saj prej 8,4m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 1,0m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinës është prej 1,00m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
29	6,925	Urë, H.D=10m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 10m ndërsa gjerësia e saj prej 6,6m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 8,4m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m. Mungojnë totuaret, bankinat dhe sistemet kufizuese anësore.
30	7,015	Urë	Urë me 1 hapësirë, me ballna betoni, mbistruktura është qemer prej betoni . Gjatësia totale e mbistrukturës është 5,2m ndërsa gjerësia e saj prej 8,4m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 2,0m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,90m. Mungojnë totuaret dhe bankinat. Si sisteme kufizuese anësore ka parrmak prej beton armeje.
31	7,5	Tombino e re Ø1000mm	Ka probleme ky segment, meqenese nuk ka ku shkarkojne ujërat e rrugës

32	7,7	Tombino Ø600mm	Tombino rrethore prej betoni me diametër (0.90 – 1.00) metra me portale të drejta prej betoni. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,5m dhe gjerësia e saj është prej 7,00m. Kemi dy vija kalimi megjerësi prej 2,75m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m vetëm ne një të tombinos. Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
33	7,975	Urë, H.D=3.0m	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 3,00m ndërsa gjerësia e saj prej 6,70m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej (2,50 metrash në drejtimin gjatësor të urës dhe 1,50 në drejtimin më të shkurtër)m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,95m. Mungojnë totuaret, bankinat dhe sistemet kufizuese anësore.
34	8,43	Tombino Ø300mm	Tub çeliku me diametër afërsisht 30cm dhe me portale prej betoni në formë pusetash katrore që largojnë ujin. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 1,2m dhe gjerësia e saj është prej 5,80m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,12m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 0,5m . Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
35	8,61	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 3,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,70m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 1,5m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,1m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
36	9,25	Tombino e re Ø1000mm	Ka probleme ky segment, meqenese nuk ka ku shkakrkojne ujërat e rrugës
37	9,4	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 3,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,70m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 1,5m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,25m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 0,9m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
38	9,582	Tombino per kalim kanali vaditësØ600mm	Behet kailimi I kanalitvaditës nga njeri krah ne krahun tjetet. Kjo vepr nuk do te levizet
39	9,988	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 3,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,70m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 2,5m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,25m, ndërsa

			gjerësia e bankinave është prej 0,9m. Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
40	10,13	Tombino e re Ø800mm	Ka probleme ky segment, meqenese nuk ka ku shkarkojne ujërat e rrugës
41	10,3	Tombino	Tombino rrethore me diametër prej 0,4 metra me pusetë në hyrje portal të drejtë në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 1,5m dhe gjerësia e saj është prej 8,00m. Kemi dy vija kalimi megjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m . Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
42	10,5	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse ne këtë segment kalon kanali kullues dhe ka probleme me largimin e ujërave te rrugës
43	10,65	Tombino	Tombino rrethore me diametër prej 0,8 metra me portal të drejtë në hyrje e në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 2,0m dhe gjerësia e saj është prej 9,00m. Kemi dy vija kalimi megjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,50m . Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
44	10,775	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse ne këtë segment ka probleme me largimin e ujërave te rrugës
45	10,913	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 2,00m ndërsa gjerësia e saj prej 9,00m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 1,5m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,2m. Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
46	11,061	Tombino	Tombino rrethore me diametër prej 0,6 metra me pusetë në hyrje portal të drejtë në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 1,5m dhe gjerësia e saj është prej 8,00m. Kemi dy vija kalimi megjerësi prej 2,80m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m . Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
47	11,23	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse ne këtë segment ka probleme me largimin e ujërave te rrugës
48	11,35	Tombino	Tombino rrethore me diametër prej 0,8 metra me pusetë në hyrje portal të drejtë në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 1,5m dhe gjerësia e saj është prej 9,00m. Kemi dy vija kalimi megjerësi prej 3,50m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m . Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
49	11,535	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 1,50m ndërsa gjerësia e saj

			prej 8,50m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 0,90m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,50m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,50m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
50	11,785	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse ne këtë segment ka probleme me largimin e ujërave te rrugës
51	11,9	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 1,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,50m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 0,90m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,80m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,50m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
52	11,94	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse ne këtë segment ka probleme me largimin e ujërave te rrugës
53	12,035	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse ne këtë segment ka probleme me largimin e ujërave te rrugës
54	12,125	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend.Gjatësia totale e mbistrukturës është 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,50m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 2,00m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,25m. Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
55	12,44	Tombino	Tombino rrethore me diametër prej 0,8 metra me pusetë në hyrje portal të drejtë në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 1,5m dhe gjerësia e saj është prej 8,00m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m . Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
56	12,52	Tombino	Tombino rrethore me diametër prej 0,8 metra me portal të drejtë në hyrje dhe në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është prej 1,5m dhe gjerësia e saj është prej 8,00m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m . Mungojnë totuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
57	12,615	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse ne këtë segment ka probleme me largimin e ujërave te rrugës
58	13,165	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend dhe pusetë nga njëra anë.Gjatësia totale e mbistrukturës është 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 10,0m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 2,00m. Kemi dy vija kalimi me

			gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,50m dhe e trotuareve është 2,50. Mungojnë sistemet kufizuese anësore.
59	14,825	Urë	Urë me 1 hapësirë dhe mbistrukturë të përbërë me soletë të hedhur në vend dhe kanale vaditës në të dy krahët. Gjatësia totale e mbistrukturës është 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 7,70m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 1,60m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 0,8m. Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
60	15,05	Tombino e re Ø800mm	Meqenëse në këtë segment ka probleme me largimin e ujërave të rrugës
61	15,75	Tombino	Tombino me hapësirë dritë 2.00 m dhe qemer hark dhe me portal të drejtë në hyrje dhe në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,00m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 2,00m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,70m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,00m. Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
62	16,68	Tombino Ø600mm	Tombino ekzistuese që bënë kalimin e ujit të kanalit ekzistues vaditës
63	16,84	Tombino Ø600mm	Tombino ekzistuese që bënë kalimin e ujit të kanalit ekzistues vaditës
64	17,233	Tombino Ø600mm	Vepër ekzistuese që bënë kalimin e ujit të kanalit ekzistues vaditës
65	17,25	Tombino	Tombino me hapësirë dritë 2.00 m dhe qemer hark dhe me portal të drejtë në hyrje dhe në dalje. Gjatësia totale e mbistrukturës është 2,50m ndërsa gjerësia e saj prej 8,00m. Ura ka një hapësirë me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 2,00m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 2,60m, ndërsa gjerësia e bankinave është prej 1,50m. Mungojnë trotuaret dhe sistemet kufizuese anësore.
66	17,43	Tombino Ø600mm	Tombino ekzistuese që bënë kalimin e ujit të kanalit ekzistues vaditës
67	17,585	Tombino Ø600mm	Tombino ekzistuese që bënë kalimin e ujit të kanalit ekzistues vaditës
68	17,85	Urë mbi perroin e Gostimes	Urë me 4 hapësira dritë me nga 12 m secila, me ballna dhe pila prej betoni masiv, me çemer në formë harku me trashësi 85cm mbistruktura me soletë të hedhur në vend. Gjatësia totale e mbistrukturës është 18,00m ndërsa gjerësia e saj prej 8,00m. Ura ka 4 hapësira me gjatësi të hapësirës dritë të një kampate prej 12,00m. Kemi dy vija kalimi me gjerësi prej 3,00m, ndërsa gjerësia e trotuareve është prej 1,40m në të

			dy anët .Ska bankina.Si sisteme kufizuese përdoren parrmakë beton armeje.
automobilistike. Se bashku me rritjen e numrit të mjeteve, rritet edhe numri i aksidenteve dhe ndotja e mjedisit.

Në përgjithësi, pritet që rreziqet e sigurimit rrugor do të rriten në rradhë të parë në ata sektorë që kalojnë përmes vendeve të hapura ose pranë vendbanimeve të vogla gjatë rrugës. Ndertimet në anë të rrugës rrisin rrezikshmerine e jetes së njeriut. Sidoqoftë, vënia e shenjave rrugore dhe treguesve rrugorë në pikat e konflikteve potenciale përmirëson sigurinë rrugore për të gjithë përdoruesit.

7.4.7.4 Ndikimet përfituese

- Ulja e sasisë së gazeve, tymrave dhe pluhrave të shkarkuara nga trafiku. Në saje të shpejtësisë së madhe, djegia e karburanteve është më efektive, që u korrespondon shkarkimeve më të ulta të gazeve toksikë. Megjithatë, një shpejtësi më e madhe çon në një konsum të rritur të lëndës djegëse që gjeneron gaz serë (CO_2 etj.).
- Përmirësimi i drenazhit të rrugës; ulja e numrit të aksidenteve si rezultat i përmirësimit të kushteve sipërfaqësore të rrugës.
- Përfitime social-ekonomike. Shitja drejtpërdrejt në anë të rrugës do të rrisë të ardhurat dhe mallrat transportohen shumë më shpejt se tani (ulet kostoja e transportit dhe komoditeti rritet). Ulet kostoja operationale e automjeteve si rezultat i përmirësimit të gjeometrisë vertikale e horizontale të rrugës dhe përmirësohet cilësia e drejtimit të automjeteve.

7.5 Vlerësimi i përgjithshëm i performancës mjedisore

Natyrë e projektit duhet të jetë e tillë që shumica e punimeve realizohen në renditjen e duhur, kështu që shmangët ose pakësohet shkalla e efekteve keqësuese.

Gjatë fazës operationale shkalla e punimeve, niveli i trafikut etj, kanë pak gjasa të jenë mjaft të lartë në atë shkallë sa të shkaktojnë shqetësime në lidhje me zhurmat, ndotjen e ajrit ose lëvizjen e automjeteve dhe këmbësorëve.

Në fazën ndërtimore të projektit ndikimet keqësuese mund të zbuten kënaqshëm, ose me anën e projektimit të mirë inxhinierik, ose përmes adoptimit dhe përforcimit të kushteve mbrojtëse mjedisore në kontratat ndërtimore. Megjithatë do të jenë të pranishëm rreziqet e sigurimit rrugor në rritje me shpejtësinë e madhe të automjeteve dhe volumin më të madh të trafikut gjatë operimeve.

Ndikimet më të rëndësishme mjedisore dhe sociale janë si vijon:

- Humbje e drurëve, shkurreve e gjerdeheve të gjelbër;
- Pluhur dhe ngritje tymi në stadin ndërtimor që mund të shkaktojë probleme në banorët pranë rrugës;
- Mungesa e vendeve për depozitim të gjitha mbetjeve të përdorshme të ndërtimit.

7.6 Masat zbutëse dhe masat për rritjen e përfitimeve mjedisore

7.6.1 Masat zbutëse

Masat zbutëse dhe vlerësuese për t'u marrë janë të shumëllojshme. Masat kryesore janë paraqitur shkurt për fazat (stadet) ndërtimore dhe zbatuese të projektit. Masat janë ndarë në masa zbutëse të detyrueshme dhe në masa zbutëse të rekomanduara shtesë.

7.6.2 Stadi ndërtimor zbatues. Masa zbutëse të detyrueshme

- Të pakësohet në minimum ndotja e tokës dhe burimeve ujore në sheshet e ndërtimit të kontraktuesve dhe vendet e punës si pasojë e keqfunksionimit të ambjentëve sanitare, krijimit të mbetjeve si dhe rrezikut të derdhjeve dhe rrjedhjeve të materialeve ndotëse. Kontraktorëve do t'u kërkohet të bëjnë projekt-propozimet e tyre për të parandaluar dhe minimizuar këto burime potenciale të ndotjes;
- Futja e teknologjise se re në ndërtim me nivel të ulët zhurme dhe perdorimi i mjeteve me goma;
- Prerja e asfalteve me teknologjine e kohes, pa zhurme dhe pluhur (me perdorim uji);
- Perdorimi i mjeteve te mbuluara per largimin e mbetjeve te ndertimit qe shkaktojne ndotje suplementare, dhe riciklimi i mbetjeve te ndertimit qe mund te riperdoren, (asfaltet, hekurat e ndertimit, pjese metalike, etj.);
- Filtrimi i ujërave qe ngelen nga perdorimi ne fushen e ndertimit dhe qe ndotin token (ujërat me çimento, me acide, lëng xhami, ujërat e makinerive te ndertimit);
- Të gjitha ujërat e kontaminuara që përdoren në ndërtime do të trajtohen në mënyrë të përshtatshme. Rekomandohet që uji duhet së pari të kalojë në një seri filtrash ku përdoret edhe rëra ose pellgje precipitimi dhe së fundi, të infiltrohet në tokë ose të derdhet në lumë;
- Të merren të gjitha masat për të siguruar nivelin e duhur të sigurisë dhe higjienës në punë (pajisja e punëtorëve me doreza, maska mbrojtëse, helmetë, etj);
- Spërkatja me ujë e sipërfaqeve të rrugëve të pashtruara për të evituar ngritjen e pluhrave gjatë periudhave me thatësi;
- Minimizimi i sasive të mbetjeve të kantjerit nëpërmjet ripërdorimit të tyre. Depozitimi përfundimtar i mbetjeve ndërtimore është përgjegjësi e kontraktuesve në bashkëpunim me autoritetet bashkiake. Është i nevojshëm një asgjësim përfundimtar dhe i përshtatshëm i mbetjeve;

- Me qëllim që të pakësohet shkarkimi i tymrave dhe shtimi i zhurmave, kontraktuesit duhet të mundësojnë përdorimin e makinerive moderne me nivel të ulët zhurme dhe shkarkime të ulta të gazeve dhe tymrave;
- Me qëllim që të ulët ndikimi për banorët dhe mjedisin, duhet bërë monitorimi për të kontrolluar parametrat kryesorë ndotës gjatë ndërtimit (pluhur, zhurmë, kontaminim uji, mbetje të ngurta);
- Të shihen të gjitha mundësitë e ripërdorimit të shtresave dhe asfalteve, me synom evitimin e hedhjes së tyre në vende të papërshtatshme.

7.6.3 Stadi ndërtimor zbatues. Masa zbutëse të rekomanduara shtesë

- Sisteme sinjalizimi të përkohshme trafiku dhe shenja rrugore për të rritur sigurinë rrugore gjatë ndërtimit;
- Në terrenet ku banesat janë ngjitur me rrugën, puna duhet të kryhet vetëm gjatë ditës për të mënjanuar zhurmën, pluhurin dhe shkarkimin e tymit gjatë natës.

7.6.4 Stadi i shfrytëzimit. Masa zbutëse të detyrueshme

- Uji që vjen prej sipërfaqeve të ndërtimeve duhet të mblidhet duke përdorur një sistem drenazhimi. Vija (rryma) e infiltrimit në tokë duhet të jetë sa më e gjatë të jetë e mundur. Uji nuk duhet t'i drejtohet mjedisit receptor në se është i kontaminuar me substanca organike dhe inorganike;
- Atje ku drurët dhe bordurat e gjelbëra duhet të priten për vendosjen e objekteve ndërtimore, duhet të bëhet zëvendësimi i tyre kudo ku është e mundur;
- Gardhet e gjelbër duhen rimbjellë pasi ata ndihmojnë pakësimin e pluhrave dhe shkarkimeve të tjera dhe ruajnë banesat ngjitur me rrugën;
- Pavarësisht nga rritja e shpejtësisë së makinave, siguria rrugore duhet të përmirësohet me sinjaletikë të përshtatshme rrugore, shënime rrugore dhe kontroll policor;
- Përdorimi i mbikalimeve për të siguruar banorët nga aksidentet;
- Implementimi i një sistemi monitorimi mjedisor për kontrollin e cilësisë së ajrit dhe të ujit;

7.7 Rekomandime për stadet e ndërtimit dhe përdorimit

Për të pakësuar ndikimin që shoqëron shpronësimin e tokës dhe pronës rekomandohet të adoptohen tre parime themelore:

- Projektet inxhinierike të përgatiten të tillë që shkalla e shpronësimit të tokës dhe pronës të jetë minimale;

- Kompensimi i plotë dhe CASH t'u paguhet të gjithë atyre që preken nga shpronësimi i tokës dhe pronës;
- Organet kompetente duhet të fillojnë diskutimet me autoritetet bashkiake për vendosjen e opsioneve të përshtatshme për rivendosjen e bizneseve të prekura potencialisht në vendet e duhura alternative;

Do të jepen konsiderata për shtendosjen e standarteve të projekteve që tëçojnë në pakësimin e shpronësimeve të tokës dhe pasurive pa kompromentim domethënës të funksioneve të objekteve.

Zbutja efektive mundësohet duke u kërkuar kontraktuesve të marrin të gjitha masat paraprake për pakësimin e ndotjes dhe për të siguruar këtë të gjitha vendet vihen në kushte të pastra e të rregullta për të përmbushur punimet e ndërtimit. Ndikimet mund minimizohen duke u kërkuar kontraktuesve të kryejnë rregullimet për një furnizim privat me ujë, që nuk do të prekte të drejtën e të tjerëve.

Pakësimi efektiv i mbetjeve mundësohet vetëm me sigurimin e një sistemimi në mënyrë të kontrolluar dhe vetëm në vendet e zgjedhura për këtë qëllim.

Gjatë stadiit të projektimit të hollësishëm do të identifikohen vendet për sistemimin e dherave të ndërtimit duke llogaritur nevojat, për të pakësuar efektet potenciale keqësuese në minimum. Do të bëhen përpjekje për identifikimin e vendeve si guroret e vjetra dhe gropat, të cilat mund të rimbushen, pa pasur nevojë për të gjetur vende të reja.

Në të gjitha llojet e punimeve do të minimizohet prerja e drurëve pa kompromentuar gjeometrinë e rrugës.

7.8 Rekomandime që lidhen me mungesën e informacionit dhe aktivitetet e mëtejshme

Pavarësisht identifikimit të impakteve, si dhe propozimit të masave zbutëse ndaj tyre nga VNM, rekomandohet që të bëhen disa investigime shtesë:

- Organizimi i pjesëmarrjes publike për projektin e rrugës. Organizimi i ditëve të hapura të Boboshticës, ku banorët mund të diskutojnë ndonjë shqetësim mjedisor që mund të kenë;

Intervistimi i banorëve që jetojnë pranë rrugës që propozohet të ndërtohen sistemohet dhe asfaltohet. Çdo shqetësim serioz duhet të diskutohet me ta dhe të merren masa zbutëse të përshtatshme.

7.9 Dispozitat për permiresimin e kushteve mjedisore

Propozohet të përfshihen klauzolat e listuara më poshtë në dokumentet e tenderit.

7.9.1 Kushtet kontraktore

Klauzolat lidhur me kushtet duhet të përfshihen në kontratën e ndërtimit me qëllim që kontraktuesi:

- Të përgatisë vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) nga zbatimi i projektit të sistëmit dhe asfaltimit të rrugës përpara fillimit të punimeve;
- VNM duhet të paraqesë parapërgatitje specifike të përshtatëshme për sistemin e mbetjeve sanitare e të tjera në një mënyrë që nuk do të rezultonte asnjë formë ndotje ose rreziku për shëndetin e njerëzve ose kafshëve;
- Të marrë masa të arsyeshme paraprake për të ndaluar derdhjet dhe rrjedhjet e materialeve me mundësi për të ndotur vendin ose burimet ujore dhe të përshkruhen hollësisht masat që ai propozon të adoptojë në VNM. Masat paraprake do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në masa fizike. Masat do të mbahen në kushte efektive gjatë gjithë periudhës kontraktuese;
- Të jetë përgjegjës për pastrimin e çfarëdo ndotjeje të shkaktuar me aktivitetin e tyre dhe të paguajë për atë që ka dëmtuar (shkaktuar);
- Të sigurojë që sheshi i ndërtimit dhe të gjithë vendet e punës të lihen në gjendje të qetë e të pastër në përfundim të punës ndërtimore dhe vendet të rikthehen, sa më shumë të jetë e mundur, në gjendjen e tyre origjinale;
- Të jetë përgjegjës për të bërë rregullimet e duhura për furnizimin me ujë për ndërtime dhe qëllime të tjera dhe kjo mos të prekë cilësinë ose aftësinë e burimeve të ujërave mbi e nëntokësorë të përdoruesve ekzistues;
- VNM-ja e kontraktuesit duhet të përfshijë hollësi për rregullimet e tyre, të propozuara lidhur me furnizimin me ujë për qëllime ndërtimi.

Përveç të tjerave, klauzolat duhet të përfshihen në kontratën e ndërtimit, që kontraktuesi:

- Të specifikojë me hollësi “ Programin e punës ” të përgatitur gjatë periudhës së mobilizimit, datën më të herëshme në të cilën do të fillojnë punimet ndërtimore në çdo vend ku mund të kërkohet rivendosja e shërbimit;
- Të jetë përgjegjës për marrjen dhe verifikimin e informacionit për të gjithë shërbimet ekzistuese që ndodhen brenda ose ngjitur punimeve ndërtimore dhe për sigurimin e tyre që asnjë dëmtim nuk do t’u shkaktohet gjatë punimeve;
- Të sigurohen që gjithë prishjet ndërtimore do të depozitohen në vendet e miratuara;
- Të ndalohen të mbahen pjesë me rrezik shembjeje;
- Të hidhen të gjitha hapat e arsyeshëm për të minimizuar të papriturat e pakëndshme dhe rreziqet rrugore të përdoruesve të tjerë. Përveç të tjerave, të rregullohet koha e transportimit për të shmangur pikun e trafikut;

- Të merren masat e duhura për minimizimin e rreziqeve rrugore duke i shoqëruar ato me një diversitet kohor trafiku gjatëçdo aktiviteti ndërtimor;
- Të jetë përgjegjës për heqjen e mbeturinave të përkohshme pas përfundimit të ndërtimit dhe për të kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme tokën dhe burimet ujore.
- Një kthim i tillë duhet të përfshijë edhe heqjen e gjithë materialeve të rezultuara, rindërtimin e tarracave dhe shkriftimin e thellë të tokës së ngjeshur në trojet bujqësore;
- Të përdorë makina për punë ndërtimore, makineri e materiale që kanë tipe dhe kapacitete të përshtatëshme për përdorimet e tyre të synuara;
- Të bëjnë riparimet e duhura për strukturat ndërtimore ose shtrimin e rrugës që do të paraqesin dëmtime si rezultat i pakujdesive ose nga kalimi i automjeteve.

7.10 Plani i monitorimit mjedisor

Në kontekstin e projektit menaxhimi mjedisor lidhet me zbatimin e masave të nevojshme për të pakësuar dhe mënjanuar ndikimet negative dhe rritjen e ndikimeve përfituese. Për të qenë efektiv, menaxhimi mjedisor duhet të jetë plotësisht i integruar në përpjekjet e përgjithshme të menaxhimit të projektit në të gjithë nivelet, me synim kryerjen në nivel të lartë të kontrollit të cilësisë, si dhe zbatimin dhe funksionimin efektiv të projektit.

7.10.1 Monitorimi Mjedisor

7.10.1.1 Analizat e ajrit

Rekomandohet të kryhen analiza të cilësisë së ajrit gjatë fazës (stadit) të ndërtimit në pika të caktuara monitorimi si vijon:

- Lënda e ngurtë pezull LGS ;
- Grimcat PM_{10}
- Dyoksidi i squfurit SO_2 ;
- Dyoksidi i azotit NO_2 ;
- Ozoni O_3 ;
- Plumbi Pb .

Të njëjtat pika monitorimi mund të përdoren gjatë fazës së zbatimit. Parametrat që analizohen janë:

- Grimcat PM_{10} ;
- Dyoksidi i squfurit SO_2 ;
- oksidet e azotit NO_x ;
- Monoksidi i karbonit CO ;

- Hidrokarburet e absorbueshëm.

7.10.1.2 Analizat e ujit

Gjatë stadi ndërtimor do të ishte e nevojshme të analizohen vetëm pak parametra në pikat e shkarkimit, pas kalimit në filtër rëre ose në pellg precipitimi:

- UV 254 për ndotës që shfaqen gjatë ndërtimeve (naftë, benzinë, graso dhe substanca të tjera që varen prej materialeve të përdorura).

Analizat duhet të kryhen 1 herë në muaj ose siç e shikon të nevojshme ekipi monitorues.

Gjatë stadi të zbatimit duhet të analizohen më shumë parametra, por vetëm kur uji është i përshtatshëm (gjatë stineve me shi ose reshje, pas një stine me thatësi).

Parametrat që analizohen janë:

- UV 254;
- Hidrokarburet e ekstraktuar;
- Plumbi;
- Metalet e tjerë të rëndë (sipas kërkesës *Cd, Cr*);
- *TOC* (nëse është e mundur);
- pH;
- Përcjellshmëria.

7.10.2 Faza e projektimit

Menaxhimi mjedisor i projektit do të lidhet me katër grupe kryesore të aktiviteteve:

- Përgatitja e hollësive të projektit, bazuar në procedurat që synojnë në minimizimin e ndonjë ndikimi keqësues ose përfshirjen e ndikimeve përfituese;
- Përgatitja e dokumenteve kontraktuese të ndërtimit dhe të tenderave, që përmbajnë klauzola të përshtatshme të ndikimeve që vijnë prej veprimtarive ndërtimore;
- Rishikimi dhe përditësimi i monitorimit mjedisor dhe plani menaxhues të përfshijnë ndonjë amendament që mund të dalë gjatë fazës së hollësishme të skicimit (hartimit);

7.10.3 Faza e ndërtimit

Shumica e veprimtarive të menaxhimit mjedisor të projektit të do të kryhet gjatë fazës ndërtimore, kur mund të priten të dalin shumica e ndikimeve. Menaxhimi do të lidhet me ndikimet kontrolluese që mund të rezultojnë prej veprimeve të kontraktuesit, përmes forcimit të kushteve të kontratave ndërtimore që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Përsa i takon kësaj, zbutje e suksesshme e ndikimit ndërtimor mund të arrihet vetëm nëse masat mbrojtëse mjedisore siç dalin në kontratën ndërtimore, janë përforcuar si duhet.

Përgjegjësia e plotë për supervizionin e ndërtimit, menaxhimin e kontratës dhe menaxhimi mjedisor gjatë ndërtimit do të ketë të bëjë me Konsulentin. Klienti do të mund të marrë në punë një nënkontraktues si Institutin e Shëndetit Publik për veprimtaritë monitoruese.

Sidoqoftë, autoritet që kanë të bëjnë me supervizionin e përditshëm, do t'ja delegojnë inxhinierit vendas. Nëse kërkohet prej Klientit, një ekspert mjedisor do të mund të kryente kontroll për të mbështetur Konsulentin dhe ekipin vendor të tij.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar vendosjes së procedurave me anë të të cilave aksionet emergjente mund të merren prej stafit vendor në rastin e zëvendës kontraktuesit të papërgjegjshëm që mund të shkaktojë dëm mjedisor imediat dhe të konsiderueshëm (për shembull probleme që shoqërohen me kontaminimin e tokës, ujërave nëntokësore e sipërfaqësore prej përdorimit të papërshtatshëm të substancave tëkontaminuara).

7.10.4 Faza e zbatimit dhe mirëmbajtjes

Përfitimet nga zbatimi i projektit do të arrihen kur ai të kryhet në kohën e duhur.

Menaxhimi dhe monitorimi mjedisor do të jetë përgjegjësi e Klientit.

8 Studimi Topografik.

Studimi topografik për këtë projekt në përputhje me kërkesat e TeR, u realizua nga dy grupe subjekte projektuesish, subjekti i parë me drejtues teknik Inxh. Sokol Allaraj, me Nr. Licence: LIC TZ 0332 dhe subjekti i dytë "GEOMATICA" sh.p.k. me administratori Inxh. Jak SULI.

Më poshtëpo tregojmë përshkrimin e punës së kryer nga secili subjekt.

8.1 Segmenti Elbasan - Cërrik dhe Papër Cërrik

Hartuar nga subjekti i parë. Nga ana planimetrike aksi paraqitet përgjithësisht i shtrirë pa thyerje dhe ka parametra optimalë për zonat urbane. Në drejtimin gjatësor objekti ka një pjerrësi të lehtë me ulje dhe ngjitje te vogla nga veri-lindja drejt jug - perëndimit deri në Cërrik, dhe pastaj vazhdon me ulje konstante te kuotës nga Cërriku në drejtim të urës se Papërit.

Në drejtimin tërthor terreni ka thyerje te shpeshta te lehta te tipit fushor, të cilat kanë ardhur si për shkak të skarpatës së rrugës ekzistuese edhe për shkak të kanaleve ekzistuese kulluese dhe vaditëse. Kështu që objekti nëanën altimetrike është i shtrirë në tëgjithë gjatësinë duke mos pasur disnivele tëmëdha të niveletës. Gjatëgjithëgjatësisë ajo niveletë është me segmente me pjerrësi te vogla ose shume te vogla. Kjo pjerrësi diktohet nga shtrirja e rrugës ne një zone me karakter fiziko-gjeografik fushore.

Para fillimit të punimeve kemibere njëinspektim tëhollësishtëm ne terren dhe kemi grumbulluar materialet e nevojshme topografike ekzistuese për te gjithëzonën ku shtrihet objekti.

Materialet topografike dhe hartografike ekzistuese qe do tëna ndihmojnë për kryerjen e rilevimit që përdorëm janë:

Hartat baze për realizimin e Projektit janë:

Hartat topografike te shkalles 1:25.000

- Nomenklaturë K-34-101-C-a
- Nomenklaturë K-34-088-C-c
- Nomenklaturë K-34-100-D-d

Hartat topografike te shkalles 1:10.000

- Nomenklaturë K-34-101-C-c-1
- Nomenklaturë K-34-101-C-c-2
- Nomenklaturë K-34-101-C-a-4
- Nomenklaturë K-34-101-C-c-3
- Nomenklaturë K-34-100-D-d-4

- Nomenklaturë K-34-100-D-d-2

Materiale të tjera ndihmese qëpërdorëm ne procesin e kryerjes se rilevimit janë edhe ortofotot (fotot aerofotogrametrike).

Për të siguruar që të gjithë matjet topografike dhe hartimi i relievit të jetë i mbështetur në rrjetin shtetëror të koordinatave gjeodezike, ndërtoam një poligon teshtrire në të gjithë gjatësinë e aksit të rrugës ekzistuese dhe të lidhur në dy pika terrjetit të vjetër ekzistues shtetëror të koordinatave.

Fiksimi i pikave të poligonit në terren është bërë me shufra hekuri në beton dhe qendrueshme nga agjentet atmosferike dhe demtimet fizike. Ata janë vendosur në vende të dukshme dhe në afërsi të rrugës ekzistuese. Identiteti i tyre është fiksuar menjëherë të kuqe të shkruar në afërsi të pikave dhe në vende të dukshme. Pikat janë të vendosura në vende të qëndrueshme nga ana gjeologjike, kanë pamje të ndërsjellë, duke siguruar në këtë mënyrë lidhjen ndërmjet tyre dhe vazhdimësinë e punës, nga faza e projektimit në fazën dhe në fazën e zbatimit të projektit.

Sistemi i koordinatave ekzistuese në Republikën e Shqipërisë është i bazuar në projeksionin Gauss Kryger në elipsoidin Krasovsky. Matjet tona janë bërë në sistemin ndërkombëtar UTM 34N i projektuar në elipsoidin WGS84. Me këtë sistem mund të përcaktohet lehtë koordinatat gjeodezike për çdo pikë në sipërfaqen e tokës përmes përdorimit të GPS. Matjet gjeodezike për realizimin e relievit janë kryer duke u mbështetur në një poligon të hapur të shtrirë përgjatë objektit. Pikat poligonale janë të fiksuara dhe të vizualizuara në terren. Pozicioni i tyre planimetrik, fotot përkatëse dhe Koordinatat paraqiten në katalogun e meposhtëm.

Matjet poligonale dhe ato të pikave detaje u kryen si kombinim i dy metodave, asaj GPS dhe Total Station.

Pajisjet matëse gjeodezike që përdoren në këtë proces janë:

1. GPS tipi SOKKIA GRX1
2. Instrumentin Station Total Leica tipi TM30
3. Nivelen Digitale Leica DNA10

Të gjitha pikat e detaje janë matur me GPS. Matjet me GPS duhet të japin rezultat brenda saktësisë së kërkuar. Kështu që duhen të zgjidhen metodat dhe procedurat më të përshtatshme të matjeve, me qëllim që të arrijmë një rezultat të saktë.

Metodat kryesore të zbatimit të pozicionimit të GPS-it janë:

- Statike
- Kinematike
- Pseudokinematike
- Rapid-statik

- Kinematike në kohë reale (RTK)
- Diferenciale GPS

Për të patur rezultate të sakta në ndertimin e poligonit përdoren metodën satatike.

Metoda Statike është një ndër metodat më të besueshme dhe më të sakta të përcaktimit të pozicionit, kjo nënkupton shfrytëzimin e dy ose më shumë marrësve GPS në dy ose më shumë stacione ku marrësit gjatë gjithë kohës së matjes janë të palëvizshëm, duke pranuar sinjale në mënyrë të pandërprerë prej se paku 4 satelit në një gjeometri të përshtatshme dhe në kushte normale atmosferike. Preferohet të shfrytëzohen marrësit dy frekuencor GPS në mënyrë që të bëhet eliminimi i gabimeve jonosferike dhe troposferike. Kjo metodë përdoret përvendosjen e bazave gjeodezike, për matje precize në projekte inxhinierike. Matjet i realizuam me instrumentin GPS tipi SOKKIA GRX1 dhe përpunimin e të dhënave e kemi bërë me softin sokkia survey.

Koha e vrojtimit në një pikë të poligonit është nga 90 në 150 minuta. Kjo kohë është e mjaftueshme për të siguruar zgjidhje ambiguitive.

Sistemi i koordinatave të pikave të marra nga matjet është sistemi UTM. Ky sistem nuk pengon në nxjerrjen e rezultateve.

Marrja e të dhënave të pikave detaje është bërë me GPS dhe me stacion total. Janë përdorur të dy instrumentet me qëllim që të kemi një saktësi më të lartë në të gjitha zonat ku nuk mund të masim me GPS për shkak të pengesave të ndryshme të terrenit dhe të gjeometrisë së shpërndarjes së sateliteve në hapësirë.

Të dhënat e pikave detaje me GPS janë marrë me metodën "stop & go". Pranë çdo pike detaje marrësi i GPS qëndron deri në 10 sek. Në rastet kur baza e GPS është në distancë më të madhe se 1000 m koha e qëndrimit në pikë është deri në 15 sek. Në këtë mënyrë të dhënat e marra janë brenda saktësisë së kërkuar.

Në rastet kur procesi i nivelimit është kryer me instrumentin Station Total Leica tipi TM30, kemi shpeshuar pikat e poligonit dhe saktësia e marrjes së pikave detaje është perseri brenda saktësisë së shkallës së nivelimit. Saktësia e afuar nga instrumentin Station Total Leica tipi TM30 është:

- Saktësia e matjes kendit = 1 "
- Saktësia e matjes së largësive = 0.6 mm + 1 ppm
- Distanca maksimale e matjes = 3500 m

Për të kryer procesin e nivelimit në të gjithë gjatësinë e poligonit kemi përdorur Nivelin Digjital Leica DNA10 që siguron kërkesat dhe saktësinë e kërkuar për rastet e tilla.

Të dhënat teknike të niveles janë:

- gabimi për një vijë nivelimi me gjatësi 1 km vajtje ardhje = 0.9 mm

Rrjeti i nivelimit projektohet i tille qe te krijojme njërrjet ku te perfshihen te gjithëpikat e poligonometrise qe sherbejne si baze gjeodezike për të kryer procesin erilevimit me instrumentin Total Station Leica TM 30 dhe GPS SOKKIA GRX1.

Menyra e matjes se disnivelit ndermjet pikave është metoda klasike e saktësisëse larte. Instrumenti mates ne Këtë rast është nivela Digitale Leica DNA10. Kjonivele siguron kerkesat dhe saktësiine e kërkuar. Kjo nivela dixhitale nuk ka sistemeleximi me mikrometra optikë me pllakë paralele. Tek kjo leximet në lata bëhen memënyra elektro-kompjuterike duke krahasuar imazhet e latës që vizojmë me imazhinstandartit dixhital të saj, të vendosur në kompjuterin e nivelës. Ne Këtë menyre beheti mundur eleminimi i shume gabimeve qe mund te behen për tëshenuar te dhenat emarra gjate nivelimit.

Pamje e latës barkode Pamje e leximeve dixhitale




Figura 8-1 Pamje e latës barkode dhe pamje e leximeve dixhitale

Para fillimit te punimeve duhet te behet kontrolli i niveles.

8.1.1 Procesi i matjes

Matjet janë kryer me procedurat e nivelimit të klasit të parë. Nivelimi është kryer në formën e poligonit të hapur me dy stacione të nivelës. Krahët e nivelimit janë mbajtur nga 15 m. Nëçdo stacion është bërë kontrolli që disnivelet nga dy stacionet e nivelës nuk duhet të ndryshojnë më shumë se 1mm. Gjithashtu në fund është bërë kontrolli ku:

- gjatësia e krahëve mbrapa,
- gjatësia e krahëve para.

Nivelimi duhet te behet gjatëorëve te para te mëngjesit dhe pas orës 16, për shkak të mungesës së refraksionit.

Kompesimi i rrjeti dhe rezultate përfundimtarejanë bere ne mënyrë te pavarur me softet "**Sokkia Spektrum**" dhe "**Cremer**". Rrjeti është barazuar si një rrjet 3D për matjet e bëra me instrumentin totalstation leica TPS. Vlerat e gabimeve te marra apriori janë:

- $\sigma_{\text{distanc}} = 1\text{mm} + 1\text{ppm}$
- $\sigma_{\text{hz}} = 0.7'' + 0.5\text{mm per stacion}$
- $\sigma_{\text{vz}} = 1'' + 0.5\text{mm} + 0.06$ (refraksiioni)

$$\sigma_{\text{disnivel}} = 1'' + 0.5\text{mm} + 1'' \times L (\text{km}) + 4.7\text{mm} \times L (\text{km}) \times L (\text{km})$$

Saktësia ne plan e pikave te rrjeti është marre apriori 1mm. Saktësia ne lartësi e pikave te rrjeti është marre apriori 2mm. Te gjithë perpunimet e meposhtëme jane ne varesi te kësaj saktësie. Barazimi i rrjetit është bere duke përdorur testin statistikor.

Me anen e softit përpunues analizohet gabimet e matjes se kendeve dhe te distancave. Fillimisht behet korigjimi i pikave "referent points and sight lines". Kur gjate analizimit te ketyre gabimeve del se gabimi i njëpike te rrjetit del shum i madh atehere kjo pike hiqet nga analiza e metejshme, pra nuk merret parasysh. Këto pika qe kane gabim me te madh se gabimi i pritshem hiqen nga analiza llogaritese ose përsëriten matjet ne terren. Procesi i rilevimit topografik te terrenit është bere sipas metodës klasike duke marre si pika detaje te gjithë pikat e rrugës ekzistuese, te kanaleve anesore te rrugës, kanalet e kullimit dhe te vaditjes ne perdorim per bujqesine, rrugët dytesore, ndertesat dhe objektet e ndryshme në tëdy anet e rrugës, pusetat, trotuaret, shtyllat etj. Per cdo pike detaje jane marre kordinatat X, Y, Z. Pra cdo pike është e insertuar ne file te Autocad ne 3d. Perpunimi i te dhenave te marra ngaurvejimi ne terren jane perpunuar fillimisht me programin e kompesimit te rrjeti me sokkia spectrum survey, dhe perpunimi i mëtejshëm është bere me Autocad Civil.

Lidhja e rrjetit te poligonometrise me rrjetin shtetror te koordinatave.

Për të bërë të mundur transformimin e koordinatave nga sistemi UTM (koordinatat e marra nga matjet e drejteperdrejta ne terren me GPS), lidhim Këtë poligon me dy pika te rrjetit shtetror te koordinatave. Lidhur me Këtë transformim kemi shfrytëzuar pikat e triangulacionit shtetror, pika e pare është pika e ndodhur ne jug-lindje te fshatit Muriqan. Kjo pike është pika e rendit te III. Pika e dyte është pika e Kodrës se Qytetit qe ndodhet ne lindje te Lumit Shkumbin ne një koder përballë qytetit Elbasanit ne afërsi te fshatit Hajdarani. Koordinatat e pikave jepen ne tabelën e mëposhtme:

Tabela 8-1 Koordinatat e pikave

Nr. Pikës	X	Y	Z
10160	547216.99	417058.57	74.284
10159	550728	423141.24	266.53

Tabela 8-2 Katalogu i pikave poligonale

Nr. Pikës	X	Y	Z
BM1	4413666.984	4545614.791	70.553
B10	4413945.006	4544734.265	77.102




Figura 8-2 Pozicioni në planimetri i BM1




Figura 8-3 Pozicioni në planimetri i BM10

Tabela 8-3 Katalogu i pikave të stacioneve

Nr. Pikës	X	Y	Z
ST21	4416863.415	4545322.086	82.732
ST60	4423049.172	4551882.870	107.671

ST10	4415168.678	4543874.725	84.324
ST11	4415254.454	4543828.248	85.028




Figura 8-4 Pozicioni në planimetri i pikave ST21, ST60, ST10 dhe ST11



Figura 8-5 Foto e pozicionit në terren të pikave ST21, ST60, ST10 dhe ST11

Më poshtë po tregojmë përshkrimin e punës së kryer nga secili subjekt.

8.2 Segmenti Cërrik Banjë dhe Gostimë Mollas

Ky studim është hartuar nga subjekti i dytë

Për vendosjen e bazamentit gjeodezik të mësipërm diktuar nga detyra e projektimit dhe e rilevimit u kërkuar në terren pikat e triangolacionit shtetëror të vendosura nga ish Instituti Topografik i Ushtrisë. Mbas përfundimit nga 6 pika të kërkuara u gjeten vetëm 2 pika kryesore ku u mbështetëm për vendosjen dhe llogaritjen e bazamentit gjeodezik është pika me emrin "Cërriku" me numër katalogu Nr.10012 me koordinatat e poshtëshënuara $Y=4415416.11$ $X=4544767.09$ $H=78.439$

Si edhe pika tjetër e gjetur nëkodrën e fshatit Floq me emrin "Guri i Bardhë" me numër katalogu Nr.11321 me koordinatat e poshtëshënuara

Y=4417597.37 X=4538559.89 H=305.316

Pika "Cërriku " është pike triangolacioni e rendit te pare

ndërsa pika "Guri i Bardhe "është pikë triangolacioni e rendit te dyte.

Ndonëse që të tre rendet e Triangolacionit Shqiptar mendohet qëjanë te unifikuara për nga saktësia e tyre ne ubëmënjë kontroll këtyre dy pikave. Për bazamentin gjeodezik u përdor instrumenti

G.P.S. TOPCON HIPER

Bazeline: 3mm+0.5ppm per L1 +L2

5mm+0.5ppm per L1

RTK: 10mm+1ppm per L1 +L2

15mm+1.0ppm per L1

Ndërsapër rilevim u përdore edhe instrumenti:

Total station SOKKIA POWERSET-2010

- -Saktësia në matjen e distancës :(2+2ppm x D)mm

- -Saktësia në matjen e këndit: 2"

Duke u vendosur tek pika "Cërriku" si pikë e klasit te parë kontrolluam pikën e "Guri i Bardhë" ku pas matjes së koordinatave rezultoi një diference e matjeve tona me të ITU Dy=+6.2cm dhe Dx=-2.9cm ndërsa Dh=-15cm

Ndonësepritshmëria në plan doli e shkëlqyer, ajo ne kuote nuk kënaqikërkesat tona te saktësisë. Meqenëse instrumenti i sipërpërmendur kryen matje edhe me

metodën**PosProcesing** ne e përdoremkëtëpër te eliminuar procedurat e kompensimit te

pikave te Bazamentit Gjeodezik. U mat pika "Guri i Bardhe" me një periudhe prej 180min dhe u morën rezultatet e mëposhtme te koordinatave përfundimtare te kësaj pike

Y=4417597.308 X = 4538559.920 H=305.17

Përfundimisht koordinatat e dy pikave mbështetëse të rrjetit Gjeodezik të dy rrugëvejanë :

Përfundimisht koordinatat e dy pikave mbështetëse të rrjetit Gjeodezik të dy rrugëvejanë :

Tabela 8-4 Koordinatat e pikave mbështetëse te rrjetit Gjeodezik të dy rrugëve

Emërtimi	X (Nord)	Y(East)	H (Elevation)
Cërriku	4544767.090	4415416.110	78.439
Guri i Bardhë	4538559.920	4417597.308	305.170

Mbështetur mbi këto dy pika te forta u ndërtua Poligoni Gjeodezik nga i cili u kryen matjet direkte te pikave detaje.

Te gjitha pikat e poligonit u maten me GPS me POSPROCESING me kohe 30min Mos

mbyllja e koordinatave te pikës me te dobët te poligonit qe është pika 80 (mesi i poligonit)

pas dhënies se koordinatave nga "CËRRIKU" dhe "GURI I BARDH" rezultoi 7mm ne plan dhe 12mm ne kuote. Kjo saktësi është e shkëlqyerpërqëllimin tonë dhe kënaq ne mënyrë të plotëkërkesat e detyrës se projektimit. Megjithatë ne kryem edhe shpërndarjen e gabimit duke e çuaratë në zeron teorike

Saktësia e kërkuar nga detyra e projektimit për rilevim është e saktësisëpër shkallen 1:250 Gabimi ne pozicionimin e pikës detaje ne lidhje me rrjetin mbështetës duhet te jete + - 0.2 x SH Pra =5cm. Këtësaktësi e ofron dyfish me te mire direkt vet instrumenti i përdorur gjate rilevimit Koordinatat e pikave te poligonit janë këto:

Tabela 8-5 Rruga " Cërrik-Gostimë-Banjë"

Nr. Pikës	X	Y	Z
PF10	4543874.71	4415168.65	85.29
PF11	4543828.25	4415254.45	85.96
PF74	4542633.80	4416585.12	100.91
PF75	4542624.85	4416604.42	101.37
PF76	4541863.46	4417109.75	106.96
PF200	4541028.37	4417692.03	107.64
PF78	4540623.59	4417684.52	110.09
PF77	4540602.77	4417684.21	110.52
PF80	4540553.33	4417705.93	110.29
PF97	4538767.06	4420612.62	132.47
PF100	4537789.20	4421407.93	141.30

Tabela 8-6 Rruga "Gostimë - Mollas"

Nr. Pikës	X	Y	Z
80	4539948.92	4417705.93	110.29
60	4540553.33	4416981.53	89.66
61	4539949.52	4416986.58	89.67
76	4538477.04	4416583.74	81.04
75	4538083.18	4416410.86	79.83
74	4536843.44	4416296.3	71.93
73	4536560.11	4416283.39	72.65
72	4535292.55	4416158.58	70.55
71	4534777.87	4416124.47	76.79
70	4534772.68	4416124.91	76.74
199	4534137.85	4416067.18	75.69
200	4533692.88	4415956.71	81.25

Nëplanimetrinë e paraqitur ndodhet pozicioni i këtyre pikave në material elektronik format DWG ndërsa bashkangjitur këtij materiali janë edhe fotografitë monografike te pikave

9 Studimi gjeologjik.

Ky studim nga volumi i punës së kryer është paraqitur në një lidhje më vete me titull:

RAPORT

Mbi kushtet gjeologjike Inxhinerike të rrugës ekzistuese Elbasan – Cërrik – Banjë– Mollas.

Ky raport është realizuar nga Subjekti Altea & GEOSTUDIO 2000

Nëntor 2014

10 Studimi Hidrologjik.

10.1 Të përgjithshme

10.1.1 Qëllimi:

Qëllimi i këtij studimi është që të njihen paraprakisht kushtet klimatike dhe hidrologjike të zonës, ku kalojnë itineraret e segmenteve të objektit: “Studim projektim Rruga Elbasan-Banjë, Gostimë-Mollas dhe Papër-Cërrik“. Studimi do të shërbejë gjithashtu përpërmasimin e detajuar të veprave të artit: kunatave, tobinove dhe hapësirave e lartësive të urave, që ndodhen gjatëgjurmës të segmenteve rrugor. Përmirësimi i kushteve teknike të këtyre segmenteve rrugore do të shërbejë për rritjen e intensitetit të qarkullimit të lëvizjes së automjeteve të tonazhit të ndryshëm, lehtësimin e lëvizjes së banoreve si dhe të punimeve që do të kryhen në hidrocentralin e Banjës, duke shkurtuar kohën e qarkullimit në këtë zonë.

10.1.2 Pozicioni gjeografik:

Gjurmëtimi i objektit: “**Studim projektim Rruga Elbasan-Banjë, Gostimë-Mollas dhe Papër-Cërrik**“, shtrihet në pjesën më të madhe në jug të qytetit të Elbasanit, ndërsa segmenti Papër - Cërrik shtrihet në perëndim. Ai fillon në dalje të qytetit (fillimi i Urës së Shkumbinit), vazhdon deri në Gostimë e prej këndejmerr drejtimet për në Banjë, Mollas dhe Cërrik. Përgjithësisht gjurma e segmenteve kalon rreze kodrave, në largësi 200÷300 m prej tyre. Vëmë në dukje se në përgjithësi e gjithë zona ku shtrihen segmentet rrugore, por në veçanti segmenti nga Elbasani në kryqëzimin me Gostimën, paraqitet e urbanizuar në mënyrë intensive. Efektet e këtij urbanizimi do të ndihen në veçanti në pjesën e poshtme të veprave jo kaluese.

Në vizatimin HI 023 paraqitet harta topografike dhe hidrografike e pellgjeve ujëmbledhës gjatë itinerarit të gjurmëtitimit. Pellgjet janë numërtuar sipas drejtimeve të segmenteve përkatës.

10.1.3 Te dhenat baze:

Vrojtimet sistematike për të dhënat baze hidrologjike (nivelet e ujit, prurjet e matura të ujit), që mund të shërbejnë për llogaritjen e prurjeve maksimale të rrjetit hidrografik të zonës, mungojnë. Për këtë arsye jemi mbështetur në të dhënat meteorologjike (sasine dhe intensitetin e reshjeve atmosferike) si dhe në kushtet hidrologjike të pellgjeve ujëmbledhëse. Për realizimin e këtij projekti na kanë shërbyer harta topografike shk :1:25 000 e zonës në fjale.

10.2 Kushtet klimatike

10.2.1 Zonat klimatike te territorit, ku shtrihet gjurmëtimi i rrugës:

Për të karakterizuar kushtet klimatike te gjurmëtimin rrugor te objektit: “Studim projektim Rruga Elbasan – Banjë, Gostimë-Mollas dhe Papër - Cërrik“, jane perdorur te dhenat e stacionit meteorologjik te Elbasanit, i cili ndonese ndodhet ne fillim te gjurmëtimin, paraqitet ish stacioni me i kompletuar, me i plote dhe me i sakte ne krahasim me stacionet e tjere. Itenerari i gjurmëtimin kalon kresisht ne zonen klimatike fshore qendrore, ndërsa relievi i pellgjeve ujëmbledhës dhe segmenti rrugor Gostimë-Banjëkalon neper zonen mesdhetare kodrinore qendrore. E para karakterizohet me njëklime me te bute se e dyta: me dimra te bute dhe te lageshti dhe verera relativisht te nxehta e te thata (temperatura relativisht me te larta gjate stines se veres). Ne pjesen e dyte dimrat jane me te ashper (temperaturat e ajrit jane me te ulta), por reshjet atmosferike janë të bollshme, madje edhe me shume se në tëparen.

Kushtet klimatike te zones ne studim jane karakterizuar nepermjet elementeve klimatike, qe ndikojne ndjeshem ne regjimin hidrologjik te rrjedhave ujore dhe ne arrijten parametrave optimale teknike te shtrimit te rrugës e qe jane temperatura e ajrit dhe rreshjet atmosferike.

10.2.2 Temperatura e ajrit:

Temperatura mesatare vjetore e ajrit per periudhen shumevjeçare gjate gjurmëtimin ndryshon, duke u zvogeluar, nga 15,0 grade Celsius ne Elbasan ne 14,5 grade ne Gramsh (Banje). Ajo luhetet ne vite te veçante, ne kufijte e gjurmëtimin ne njëdiapazon midis 15,5 ÷ 14,7 grade.

Muaji me i ftohte i vitit është muaji **Janar** i ndjekur, me njëndryshim te vogel, nga muaji **Shkurt**. Temperatura mesatare shumevjeçare e janarit është rreth 7 ° Celsius, me luhetje gjate viteve te veçante, nga 3,8÷9,7 ° (gjate gjurmëtimin). Pas janarit vjen shkurti me temperaturën mesatare shumevjeçare 8,4 °. Temperatura me e ulet, gjate periudhes shumevjeçare, ka arritur deri –8 ° Celsius.

Pergjithesisht temperaturat nen zero grade ose ditet me ngrica jane relativisht te shpeshta. Numri mesatar i diteve me temperaturë minimale te barabarte ose me te vogel se 0°, është mesatarisht 26 dite ne vit, i perqendruar kryesisht ne muajt dhjetor, janar shkurt. Ne pjesen e rrugës nga Gostima - Banjëky numer është me i madh.

Muajt me te nxehte te vitit jane gushti dhe korriku me temperaturat mesatare shumevjeçare te aferta midis tyre dhe perkatesisht 25,4° dhe 25,3 ° me ndryshime ne vite te veçante nga 21,5°÷24,2 °. Muaj me temperaturë mesatare shumevjeçare mbi 20° C jane vetem keto dy muajt. Pikerisht ne keta muaj vrojtohen dhe temperaturat maksimale gjate vitit. Temperatura me e larte gjate periudhes shumevjeçare ne Elbasan, ka arritur deri ne 40,0° C. Ditet e

nxehta, sipas këtij stacioni janë relativisht të shpeshta. Kështu numri mesatar i diteve me temperaturë maksimale të barabartë ose më të madhe se 30 gradë Celsius është mesatarisht 59 dite në vit, ndërsa vëroqtohen edhe dite me temperaturë maksimale të barabartë ose më të madhe se 35 °, ndonëse jo të shpeshta. Numri mesatar i këtyre diteve ka arritur gjatë periudhës shumëvjeçare në 6 dite.

Amplituda shumëvjeçare e temperaturës së ajrit arrin në 48 °÷50 °.

Në tabelën e mëposhtme (Tabela 10-1) paraqiten temperaturat mesatare mujore, maksimale dhe minimale të ajrit, si vlera mesatare të periudhës shumëvjeçare.

Tabela 10-1 Temperaturat mujore dhe ekstreme të ajrit (si mesatare shumëvjeçare) të stacionit meteorologjik të Elbasanit

Muajt	X	XI	XII	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
mes	15,9	11,5	7,7	6,9	8,2	10,0	13,5	18,2	21,2	23,2	23,3	20,6
max	22,2	16,8	12,3	10,9	12,7	15,4	19,2	24,7	27,8	30,4	30,8	27,4
min	9,6	5,8	3,2	2,9	3,6	4,7	7,8	11,7	14,6	16,0	15,9	13,8

Megjithatë temperaturat mujore ndryshojnë në vite të veçanta, në figurën e mëposhtme (Fig. 1) paraqitet ecuria vjetore e temperaturave mesatare mujore shumëvjeçare dhe e temperaturave mujore më të larta dhe më të ulëta të vërojuara gjatë periudhës shumëvjeçare.

10.2.3 Lageshtia e ajrit:

Lageshtia e ajrit është karakterizuar po nëpërmjet të dhënave të stacionit meteorologjik të Elbasanit. Lageshtia relative e ajrit për periudhën shumëvjeçare është relativisht e vogël - 68%, me ndryshime të vogla gjatë muajve të vitit nga 62% ÷ 73%. Muajt me lageshtire relative më të larta janë muajt nëntor-janar, përkatësisht me 74%, 71% dhe 70%. Në muajt e verës vërehet lageshtia relative më e vogël. Në muajt korrik dhe gusht lageshtia mesatare shumëvjeçare e ajrit është më e vogël - 62 dhe 63%. Megjithatë edhe gjatë muajve të tjere të vitit (të dimrit) vërehen dite me lageshtire relative të ulët.

Kështu, ndërsa në muajt korrik dhe gusht numri mesatar i diteve me lageshtire relative të barabartë ose më të vogël se 50% është mesatarisht 24÷26 dite për çdo muaj, gjatë muajve janar dhe shkurt ky numër është mesatarisht 15÷16 dite në muaj.




Figura 10-1Ecuria vjetore e temperaturave mujore mesatare shumevjeçaredhe temperaturave ekstreme mesatar

Persa i perket deficitit te lageshtires se ajrit mund te thuhet qe ai është relativisht i larte. Po sipas stacionit meteorologjik te Elbasanit vlera mesatare vjetore per periudhen shumevjeçare është 7,5 mb. Vlerat me te larta te tij verehen ne muajt e veres dhe me te vogelat ne dimer. Kështu ne muajt korrik dhe gusht vlera mesatare shumevjeçare arrin 13,8 mb. për tëdy muajt e mesiperm. Ne muajt janar dhe shkurt vlera mesatare shumevjeçare e deficitit te lageshtires është perkatesisht 3,6 mb dhe 3,9 mb ne muajt.

10.2.4 Reshjet atmosferike

Regjimi i reshjeve atmosferike i zones se gjurmëtimit te te tre segmenteve rrugore është karakterizuar paraprakisht nepermjet stacionit meteorologjik te Elbasanit. Ne këtë zone bie mesatarisht 1170 mm reshje ne vit.

Shperndarja e reshjeve gjate vitit, ndonese ka njëecuri te njetrajtshme, ajo është shume e ndryshueshme ne muajt te veçante. Sasia me e madhe e reshjeve është e perqendruar ne periudhen tetor-shkurt,ku bie mesatarisht njësasi reshjesh sa 61% e sasise vjetore. Kuptohet, ne muajt e periudhes qe mbetet, bie shume me pak reshje. Muajt me me shume reshje gjate vitit jane nentori dhe dhjetori me sasine mesatare shumevjeçare perkatesisht 169 mm (14,4%), i pasuar nga dhjetori me 152 mm (13%).

Muajt me me pak reshje gjate periudhes shumevjeçare jane korriku dhe gushti me sasine mesatare shumevjeçare prej 30 mm. dhe 40 mm ose sa 2,6%÷3,4% e sasise totale vjetore. Raporti mesatar midis muajit me me shume reshje dhe atij me me pak, gjate periudhes shumevjeçare, është me shemu se 1 me 4.

Ne tabelen e meposhtëme (Tab.10- 2) paraqitet shperndarja e reshjeve mujore brenda vitit hidrologjik per periudhen shumevjeçare ne stacionin meteorologjik te Elbasanit.

Tabela 10-2Shperndarja brendavjetore e reshjeve, ne mm dhe ne % te sasisëvjetore per periudhen shumevjeçare

Muajt	X	XI	XII	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
Sasia	114	169	152	146	137	95	88	82	55	30	40	63
Ne %	9,7	14,4	13,0	12,5	11,7	8,1	7,5	7,0	4,7	2,6	3,4	5,4

Ne periudhen e veres (qershor-gusht) sasia e rreshjeve atmosferike, sidomos gjate muajit qershor ndryshon shume. Kështu ne vite te veçante, ajo ndryshon nga 0 mm/muaj ne 121 mm/muaj. Sikurse shihet, ne muaj te veçante te veres, te periudhes shumevjeçare, rreshjet atmosferike mungojne teresisht gjate gjithe muajit, nderkohe qe ne vite te veçante ato krahasohen me ato te muajve te dimrit. Grafikisht njëdukuri e tille shihet ne figurën e meposhtëme (Fig. 3), ku paraqiten vlerat mesatare shumevjeçare dhe vlerat skajore mujore ne vite konkrete te periudhes shumevjeçare.

Gjithe kjo sasi reshjesh, duke qene e perqendruar ne periudhen vjeshtë-dimer, ben qe numri i diteve me reshje te jete relativisht i vogel. Gjate vitit vrojtohen reshje ne me pak se 1/3 e diteve te vitit. Numri i diteve praktikisht pa reshje gjate periudhes shumevjeçare është mesatarisht 240 dite ne vit, ndërsa numri diteve me sasi reshjesh me te vogel se 1 mm është mesatarisht 260. Duke mos marre ne konsiderate reshjet nden 10 mm, qe nk ndikojne ne formimin e prurjeve maksimale dhe ne ecurine e punimeve, numri i diteve “pa reshje”arrin pothuajse ne 313 dite ne vit. Gjate gjurmëtimit te rrugës, rreshjet ne forme debore jane ngjarje e rralle.




Figura 10-2Shtresa mesatare shumevjeçare e reshjeve mujore dhesasia e tyre max. e min. per muaj dhe vite te veçante

Luhatjet e sasisë vjetore të reshjeve, nga njëri vit në tjetrin, nuk janë aq të mëdha. Analiza statistikore e këtyre luhatjeve është kryer sipas ligjit të shpërndarjes së probabiliteteve Pirson, tipi III, për vitet hidrologjike.

Nga llogaritjet, sipas kësaj mënyre, kanë rezultuar këto vlera të parametrave statistikore: koeficienti i josimetrisë rezultoi $C_s=0,78$; koeficienti i ndryshueshmërisë $C_v = 0,20$ dhe mestarja e vargut 1168.

Në Figura 10-3 paraqitet lakorja e sigurtisë së reshjeve vjetore të stacionit meteorologjik të Elbasanit, e përcaktuar sipas dy mënyrave (analitike dhe grafoanalitike).




Figura 10-3 Lakorja e sigurtisë së reshjeve vjetore në stacionin meteorologjik të Elbasanit

